



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 299 Akti

Nr. 357 Vendimi
Tiranë, më 18.3.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 16.3.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Olsi Xhavela**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**”, e ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin mars të vitit 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, komisionere Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Olsi Xhavella.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. ***** prot., datë 5.6.2018, të ILDKPKI-së, që ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit z. Olsi Xhavella, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim

që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. **** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ****, datë 19.11.2020, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë e vazhdimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Olsi Xhavella.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënat arkivore të KLGJ-së, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. **** prot., datë 14.2.2019, për subjektin e rivlerësimit, ardhur në Komision me shkresën nr. **** prot., datë 25.2.2019.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë të figurës dhe vlerësimin profesional në datën 3.3.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Olsi Xhavella; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 3.2.2021, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti u njoh me aktet e dosjes në datën 9.2.2021 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 22.2.2021.

14. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 19.2.2021, vendosi të ftojë z. Olsi Xhavella në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 22.2.2021.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 16.3.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Olsi Xhavella ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

^[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Z. Olsi Xhavella është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi **** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private: (i) para fillimit të detyrës, në vitin 2003; (ii) periodike/vjetore, për vitet 2004 – 2017; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Olsi Xhabella, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, me nr. indeksi ****, datë 30.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;

- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2017, në raport me të dhënat në “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

- 1. Apartament banimi me sip. 85 m²**, blerë në vitin 2004, në vlerën 2,900,000 lekë, ndodhur në Korçë

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sip. 85 m², në Korçë. Vlera: 2,900,000 lekë. Pjesa takuese: 50%

Burimi i krijimit: (i) kredi e marrë në “Alpha Bank”, në shumën 15,000 euro; dhe (ii) shumën 700,000 lekë paguar nga kursimet e nënës së subjektit.

1.2 Rezultoi se për blerjen e kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka lidhur pranë noterit kontratën e shitblerjes me nr. *****, datë 4.6.2004, me palë shitëse shtetasit L. Q., Zh. D., I. B., F. K. dhe R. T. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit, z. Olsi S. Xhavella. Në kontratë është përcaktuar vlera e blerjes së pasurisë prej 2,900,000 lekësh, e cila është deklaruar si e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.3 Subjekti i rivlerësimit, për pasurinë apartament me sip. 85 m², është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie nr. 1202682, lëshuar në datën 23.2.2016, për pasurinë nr. *****, z. k. *****, Korçë.

1.4 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konfirmimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, paraqiti pranë Komisionit dokumentacionin, si vijon: *kontratë kredie (shërbyer me llogari rrjedhëse nga “Alpha Bank”) nr. *****, datë 25.10.2004, nr. *****, datë 25.10.2004, me kredimarrës Olsi Xhavella, në shumën 15,000 euro; shtesë e kontratës së kredisë (shërbyer me llogari rrjedhëse nga “Alpha Bank”), nr. *****, datë 25.10.2004, me nr. *****, datë 25.10.2004; marrëveshje shtesë financimi nga “Alpha Bank”, me nr. *****, datë 25.9.2004, lidhur me shlyerjen e huas; deklarimin se është paguar nga nëna e tij në masën 700,000 lekë, të ardhura këto të siguruara nga emigracioni përgjatë viteve 1992-2005.*

1.5 Si garanci për marrjen e kredisë bankare rezultoi se subjekti ka lidhur kontratë hipoteke nga “Alpha Bank”, nr. *****, datë 25.10.2004, për bllokimin e pasurisë nr. *****, me qëllimin e sigurimit të kredisë në shumën 15,000 euro. Pas shlyerjes së kredisë është lëshuar një deklaratë noteriale nga “Alpha Bank”, nr. *****, datë 20.1.2016, për lirimin e pasurisë nr. *****, nga barra hipotekore.

1.6 Tërheqja e kredisë rezultoi se është bërë në datën 4.11.2004, në shumën prej 15,000 euro, nga subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella. Komisioni ka verifikuar dhe lëvizjet e llogarisë së subjektit Olsi Xhavella në “Alpha Bank” nga data 1.11.2004 – 21.10.2016, për pagesat e kësteve të kredisë, të cilat janë pasqyruar në analizën financiare¹.

1.7 ZVRPP-ja Korçë me shkresat nr. ***** prot., datë 26.7.2017 dhe nr. ***** prot., datë 10.4.2020, ka konfirmuar se në emër të subjektit Olsi S. Xhavella, rezulton e regjistruar pasuria nr. *****, apartament banimi me sip. 85 m².

¹ Shihni më poshtë në këtë vendim analizën financiare të hartuar nga Komisioni.

1.8 Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2004, subjekti ka deklaruar²: *apartament 2+1 me nr. pasurie *****, z. k. *****, i regjistruar pranë ZVRPP-së Korçë datë 15.6.2004, vendosur në hipotekë në favor të “Alpha Bank”. Janë paguar 15,000 euro nëpërmjet kredisë, ndërsa pjesa e mbetur nëpërmjet kontributit të pjesëtarëve të familjes (nënës dhe vëllait) me të ardhurat nga emigracioni. Në rubrikën “Të ardhurat” subjekti ka deklaruar të ardhura nga ndihma e pjesëtarëve të familjes për blerje shtëpie (nga emigracioni) në vlerën 1,500,000 lekë. Kurse në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2007, subjekti ka deklaruar dhuratë nga nëna shumë në vlerën 1,200 euro, për shlyerjen e dy kësteve të kredisë.*

1.9 Gjatë hetimit të kryer, Komisioni konstatoi disa pasaktësi dhe problematika për këtë pasuri dhe kërkoi shpjegime nga subjekti në lidhje me: *deklarimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të plotë lidhur me burimet e ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, vlerat për kontributin e secilit pjesëtar të familjes dhe mundësitë financiare, si dhe të shpjegojë pse është deklaruar se për blerjen e kësaj pasurie është përdorur kredia e marrë në “Alpha Bank”, në shumën 15,000 euro në datën 4.10.2004, kurse kontrata e blerjes së pasurisë është e datës 4.6.2004 (sipas kontratës së shitblerjes shuma është likuiduar e plotë jashtë zyrës noteriale para datës 4.6.2004).*

1.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit lidhur me burimet e ligjshme për blerjen e kësaj pasurie ka deklaruar se:

“Sikurse ka deklaruar në deklaratën Vetting, çmimi i shitjes së apartamentit me sipërfaqe 85 m², është shlyer pjesërisht nga kursimet e nënës, të akumuluar, ndër vite, për shkak të emigrimit qysh në vitet 1991-1992, në Greqi dhe pjesërisht nga unë, pas disbursimit të kredisë në shumën 15.000 euro nga ‘Alpha Bank’. Nëna ime ka qenë në marrëdhënie pothuajse të pandërprera pune prej viteve 1991, deri në vitin 2005. Pas këtij viti deri rreth vitit 2010, përsëri ka qenë në kushte emigracioni, por me ndërprerje ka jetuar përkohësisht edhe në Shqipëri (gjithsesi, në pjesën dërrmuese në Greqi). Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga emigracioni që kanë shërbyer si burim për pagimin e një pjese të çmimit, i vetmi dokumentacion që mund t’ju vë në dispozicion, janë kopjet e pasaportave të nënës sime, së bashku me lejet e qëndrimit në shtetin grek. Me gjithë përpjekjet e mia, apo të nënës dhe vëllait, objektivisht nuk kemi asnjë mundësi për të provuar marrëdhëniet e punësimit dhe të ardhurat e përfituara me dokumente zyrtare”.

1.11 Ndërsa lidhur me ekzistencën e një diference kohore ndërmjet momentit të lidhjes së kontratës së shitjes së apartamentit dhe disbursimit të kredisë, subjekti deklaroi³ se:

“Pasi kemi rënë dakord në parim me shitësen kemi diskutuar faktin që nuk dispononim të gjithë çmimin e sendit, të cilin do ta siguronim vetëm pasi të na disbursohej një kredi që unë do të merrja për këtë qëllim. Për shkak të mosnjohjes së legjislacionit apo interpretimit të gabuar të tij, banka kishte si kusht të panegociueshëm regjistrimin paraprak të banesës në emrin tim, me qëllim dhënien e kredisë dhe vendosjen e garancisë (hipotekës) mbi të.

Në kushtet e mirëbesimit, për shkak edhe të njohjeve të vjetra të nënës sime me shtetasen L.Q. (kanë punuar së bashku në ish-NSHN Korçë para viteve 1990), ramë dakord për përpilimin e kontratës së shitjes, por me kushtin e shprehur (verbal), për pagimin e diferencës së çmimit pas marrjes së kredisë. Duke qenë i impenjuar me përpilimin e kontratës me qëllimin final përfitim të kredisë, nuk i kam kushtuar vëmendje shprehjes ‘klishe’ të përdorur nga të gjithë noterët, të paktën për kohën për të cilën flasim, sipas së cilës ‘shuma është paguar jashtë zyrës noteriale. Në fakt jashtë zyrës noteriale është paguar vetëm një pjesë e çmimit.

² Shihni deklaratën periodike vjetore për vitin 2004 të paraqitur nga subjekti në ILDKPKI.

³ Shihni përgjigjet e subjektit sipas pyetësorit nr. 2.

Pra, si përfundim, duke e gjykuar të pashmangshme analizën e kësaj situatë brenda kontekstit të kohës, sqaroj që diferenca kohore ndërmjet përpilimit të kontratës së shitjes dhe pagimit të diferencës së çmimit, ka ardhur për shkakun e vetëm, që lidhet me pamundësinë e përfitimit të kredisë, pa u regjistruar fillimisht prona në regjistrat hipotekore, në emrin tim. Gjykoj që kjo pasaktësi nuk ka sjellë asnjë pasojë dhe nuk ngre asnjë dyshim për sa i përket evidentimit të ndonjë elementi që lidhet me pasaktësinë në deklaram, në kuptimin e përgjegjësisë ligjore që mbart ky fakt. Nga ana tjetër, situata dhe nevoja për strehim e familjes ka qenë emergjente, në kushtet kur banesa në të cilën kemi jetuar (në cilësinë e qiramarrësit të futur në banesë private nga shteti qysh në vitet '70, ndoshta edhe më herët), ka qenë në prag të rrënimit dhe jashtë çdo kushti minimal për të vijuar banimin”.

1.12 Komisioni pyet përsëri subjektin lidhur me këtë pasuri dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3, paraqiti deklaratë noteriale nr. ****, datë 7.12.2020, ku deklarohen dhe konfirmohen nga pala shitëse e pasurisë shtetasja L. Q., thëniet e mësipërme të subjektit lidhur me likuidimet e bëra për këtë pasuri.

1.13 Lidhur me burimin e blerjes së kësaj pasurie, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte mundësinë financiare për krijimin e burimit të ligjshëm për blerjen e saj në vlerën prej 2,900,000 lekësh.

1.14 Lidhur me burimin prej 15,000 euro, rezultoi se kredia bankare me këtë vlerë është marrë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë dhe pas regjistrimit të kësaj pasurie të paluajtshme pranë ZVRPP-së Korçë. Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të kohës se kredia e marrë prej 15,000 euro në datën 4.10.2004, ka qenë për likuidimin e detyrimit kontraktor bazuar në kontratën e shitblerjes së datës 4.6.2004.

1.15 Kontrata e shitblerjes nr. ****, datë 4.6.2004 me palë shitëse L. Q. etj. dhe palë blerëse Olsi S. Xhavella, ka përcaktuar se palët janë likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale me lidhjen e kontratës.

1.16 Në kontratën e kredisë bankare nr. ****, të datës 25.10.2004, nuk përcaktohet qëllimi dhe destinacioni i kredisë bankare të marrë nga subjekti në “Alpha Bank”.

1.17 Kredia është disbursuar nga banka në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, i cili më pas e ka tërhequr dhe disponuar *cash*. Nuk provohet dhe dokumentohet kalimi i kësaj kredie nëpërmjet veprimeve bankare, apo ndonjë forme tjetër të dokumentuar, nga llogaria e subjektit te pala shitëse e pasurisë.

1.18 Komisioni i kërkoi subjektit dokumentacion provues lidhur dhe me burimin e ligjshëm të shumë prej 700,000 lekësh, të deklaruara si të ardhura të nënës së tij nga emigracioni.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këto të ardhura të pretenduara, nuk paraqiti dokumentacion provues⁴. Subjekti nuk provoi as dhurimin e shumë 1,200 euro nga nëna në vitin 2007, për shlyerjen e dy kësteve të kredisë (deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007).

1.19 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu la barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni lidhur me gjetjet, si vijon:

- *subjekti është në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, pasi nuk ka provuar burimet e ligjshme prej 15,000 euro dhe 700,000 lekë;*
- *subjekti nuk provon me veprime dhe dokumentacion ligjor për përdorimin e kredisë së marrë në tetor të vitit 2004, si pagesë për shlyerjen e detyrimit të rrjedhur nga kontrata e qershorit 2004;*

⁴ Shihni përgjigjet e pyetësorëve të dërguar nga subjekti në Komision.

- rezultoi mosrakordim të datës së lidhjes së kontratës së shitblerjes me datën e marrjes së kredisë në bankë në vlerën prej 15,000 euro. Pra, kontrata e shitblerjes së pasurisë është lidhur në datën 4.6.2004 (ku theksohet se palët janë likuiduar jashtë zyrës noteriale), kurse kredia është përfituar në datën 4.10.2004;
- nuk vërtetohen të ardhurat e nënës së subjektit nga emigracioni, lidhur me kontributin e saj në shumën prej 700, 000 lekësh, për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2004 dhe dhurimin prej 1,200 euro në vitin 2007.

1.20 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵, deklaroi se:

“Kundërshtoj konstatimet dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni. Kam kryer një deklaram të saktë dhe të plotë, por edhe kam arritur të paraqes argumente të mjaftueshme për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

*Përveç shpjegimeve të dhëna në pyetësor, ju vë në vëmendje faktin që kontrata e mësipërme, është siguruar me hipoteke sipas kontratës nr. *****, datë 25.10.2004, duke lënë si garanci, pikërisht, apartamentin me sip. 85 m², çka provon lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet kredisë së marrë dhe qëllimit të saj. Nëse kjo kredi do të ishte e karakterit konsumator, do të ishte e mjaftueshme sigurimi i saj me dorëzani, sikurse rëndom aplikohet kjo lloj garancie në rastet e kredive konsumatore.*

Kam përmbushur detyrimin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të shumës prej 15,000 euro, që ka mbuluar një pjesë të çmimit të apartamentit me sip. 85 m². Kurse lidhur me konstatimin e mungesës së provimit të mundësisë së nënës për pagimin e shumave 700.000 lekë dhe 1.200 euro, sikurse kam deklaruar në deklaratën Vetting, çmimi i shitjes së apartamentit me sip. 85 m², është shlyer pjesërisht nga kursimet e nënës të akumuluar, ndër vite, për shkak të emigrimit qysh në vitet 1991-1992, në Greqi. Nuk disponoj dokumentacion për këto të ardhura pasi kanë punuar në kushtet e informalitetit”.

1.21 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti prova për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për pasurinë apartament banimi me sip.85 m², në Korçë.

1.22 Subjekti nuk arriti të provojë se kredia e përfituar prej 15,000 euro është përdorur si burim për blerjen e kësaj pasurie, si dhe nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar si e ardhur nga nëna e tij në vlerën prej 700,000 lekë dhe 1,200 euro.

1.23 Kontrata e shitblerjes nr. *****, datë 4.6.2004, është lidhur para noterit dhe palët kanë shprehur vullnetin e tyre të pavesuar ku kanë përcaktuar se janë likuiduar midis tyre jashtë zyrës noteriale. Pasuria apartament është e regjistruar në ZVRPP-në Korçë në emër të subjektit disa muaj përpara marrjes së kredisë prej 15,000 euro, duke përmbushur qëllimin për të cilën është lidhur kontrata.

1.24 Subjekti në prapësime ka paraqitur deklaratën noteriale me nr. *****, datë 7.12.2020, të lëshuar nga pala shitëse L. Q., ku pasqyrohet mënyra e përfitimit të çmimit dhe fakti që për pagimin e tij, është përdorur kredia e përfituar nga kontrata e kredisë datë 25.10.2004. Komisioni këtë deklaratë nuk e mori në konsideratë, për arsye se pala shitëse nuk ka qenë e përfshirë në procedurat e marrjes së kredisë dhe nuk mund ta konfirmojë këtë fakt.

1.25 Gjithashtu, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (neni 232) përcaktohet se: *“Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve*

⁵ Shihni përgjigjet e subjektit pas kalimit të barrës së provës.

për ndryshimin e kontratës ose shuarja, me anë të pagimit ose të faljes së detyrimeve në të holla, që rrjedhin nga një kontratë e bërë me dokument”.

1.26 Shpjegimet e subjektit për praktikën e bankës, mbeten vetëm në kuadër deklarativ dhe nuk u mbështeten në ndonjë provë konkrete. Legjislacioni shqiptar (Kodi Civil), por dhe praktika e bankave në raste të tilla përcakton dhe forma të tjera kontratash duke përfshirë dhe bankat si pjesë e kontratës së shitblerjes përderisa dhe banka është financuese e kredisë së përfituar sipas qëllimit dhe destinacionit të kredisë. Nuk u vërtetua nga subjekti me prova shkresore qëllimi i marrjes së kredisë prej 15,000 euro dhe destinacioni i saj. Gjithashtu, nuk u provua as kalimi i shumës të pala shitëse e pasurisë znj. L. Q. etj.,

1.27 Burimi tjetër i pretenduar nga subjekti, lidhur me të ardhurat e nënës dhe vëllait nga emigracioni, nuk u mbështetën në prova nga subjekti sipas parashikimeve të nenit D të Kushtetutës. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti vetëm kopje të pasaportës së nënës dhe vëllait dhe lejet e qëndrimit në shtetin grek, por asnjë dokumentacion tjetër provues lidhur me përfitimin e të ardhurave apo krijimin e kursimeve nga këto të ardhura të pretenduara. Në përfundim, Komisioni nuk i konsideroi bindëse shpjegimet e subjektit, i cili nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm për këto të ardhura të pretenduara.

1.28 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament banimi në Korçë

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pasurinë apartament me sip. 111.51 m², nr. ****, z. k. ****, Korçë.

2.2 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti si pasuri e blerë gjatë martesës në vlerën prej 51,600 euro. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit është deklaruar: (i) shuma 5,770,000 lekë, e përfituar me kontratën e kredisë nr. ****, datë 7.5.2014 (shihni f. 7 të deklaratës); (ii) shuma 2,000 euro, nga kursimet vetjake (referojuni deklaratën e vitit 2014); (iii) shuma 4,800 euro, për efekt të shlyerjes së detyrimit të rrjedhur nga kontrata e huas nr. ****, datë 25.4.2014, e Dhomës së Noterisë Korçë (noter A. Q.), me huadhënës shoqërinë “*****” sh.a., huamarrës Olsi Xhavella dhe Sh. Xh., për shumën 8,800 euro. Sipas deklaratës për shlyerje detyrimi nr. ****, datë 21.10.2015, detyrimi është konsideruar i shlyer, për shkak të disa të metave të sendit të pranuar nga kredidhënësi, njëkohësisht shitës i apartamentit (referojuni deklaratës së vitit 2015). Shuma 4,800 euro paguar nga shuma prej 1,000,000 lekësh, e dhuruar në formën e prikës në vitin 2010 (referojuni deklaratës së vitit 2010).

2.3 Sipas kontratës së shitblerjes nr. ****, datë 25.4.2014, me palë shitëse shoqëria tregtare “*****” sh.a., Dhoma e Noterisë Korçë për blerjen e pasurisë apartament me sip. 111.51 m², nr. ****, vol. ****, f. ****, Korçë, rezultoi se subjekti ka blerë këtë pasuri në vlerën 51,600 euro (shumë e cila është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale).

2.4 Për këtë pasuri paluajtshme është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 30.4.2014 (për pasurinë nr. ****, z. k. ****, lloji i pasurisë apartament, me sip. 111.51m², në Korçë), në emër të shtetasve Olsi Xhavella dhe Sh. Xh., në pjesë të barabarta, e konfirmuar nga ZVRPP-ja Korçë.

2.5 Kjo pasuri është në bashkëpronësi midis z. Olsi Xhavella (deklaruesi) dhe znj. Sh. Xh. (bashkëshortja), e regjistruar si pasuri e fituar gjatë martesë, pavarësisht se në cilësinë e blerësit

është deklaruesi Olsi Xhavella. Prona është hipotekuar në favor të BKT-së, deri në shlyerjen e kredisë sipas kontratës nr. *****, datë 7.5.2014.

2.6 Sipas kontratës së shitblerjes, pagesa për likuidimin e palës shitëse do të bëhej në tri këste:

- kësti i parë në shumën 2,000 euro i është paguar palës shitëse ditën e kontratës;
- kësti i dytë në shumën 40,000 euro do t'i paguhej palës shitëse brenda datës 30.4.2014, prej një kredie bankare që porositi do ta marrë në BKT;
- kësti i tretë në shumën 9,600 euro, do t'i paguhej palës shitëse brenda datës 1.4.2015.

2.7 Komisioni hartoi analizën financiare lidhur me llogaritjen e mundësisë financiare të subjektit për krijimin e vlerës prej 2,000 në momentin e nënshkrimit të kontratës në datën 2.4.2014.

Analiza për pagesën 2,000 euro për blerje apartamenti

Të ardhura Olsi Xhavella deri më 2.4.2014	275,152
Të ardhura Sh. Xh. deri më 2.4.2014	128,808
Të ardhura totale deri më 2.4.2014	403,960
Shpenzime jetese deri më 2.4.2014	197,082
Shpenzime kredie deri më 2.4.2014, në "Alpha Bank"	57,564
Shpenzime kredie deri më 2.4.2014, në "*****"	73,500
Paguar 2,000 euro për apartament	280,220
Shpenzime totale deri më 2.4.2014	608,366
Ndryshim likuiditeti 1.1.2014 – 2.4.2014	151,002
Pamundësi për pagesë 2,000 euro	-355,408

2.8 Pas analizimit të bërë nga Komisioni lidhur me mundësitë financiare, duke u bazuar te të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes deri në momentin e shlyerjes së kështit prej 2,000 euro, subjekti rezultoi se nuk kishte burime të ligjshme për krijimin e vlerës prej 2,000 euro.

2.9 Komisioni verifikoi edhe lëvizjet e llogarisë së subjektit Olsi Xhavella në BKT nga data 1.1.2014 – 31.12.2016, për pagesat e kësteve të kredisë, të cilat janë pasqyruar në analizën financiare⁶.

2.10 Për pagesën e kështit tjetër rezultoi se subjekti ka lidhur kontratë kredie bankare nr. ***** Kol., datë 7.5.2014 dhe anekset e saj në datat 7.5.2014 dhe 4.5.2014 nga BKT, për përfitimin e kredisë në shumën prej 5,770,000 lekësh. Kredia është kaluar nga banka te subjekti në datën 12.5.2014 dhe, po në këtë datë, kjo vlerë prej 5,770,000 lekësh, i ka kaluar palës shitëse shoqërisë "*****" sh.a. Rezultoi se shuma e përfituar nga kredia ka kaluar direkt në llogarinë e shitësit, bazuar në printim dokumenti për transferimin e shumës së përfituar nga kredia në llogari të shoqërisë "*****" sh.a., lëshuar nga BKT.

2.11 Për garancinë e kredisë rezultoi se është lidhur kontratë hipotekimi, nr. *****, datë 7.5.2014, nga BKT-ja për bllokimin e pasurisë nr. *****, me qëllimin e sigurimit të kredisë në shumën 5,770,000 lekë.

2.12 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur dhe një kontratë huaje nr. *****, datë 25.4.2014, me huadhënës shoqërinë "*****" sh.a., ku ka përfituar hua në shumën 8,800 euro.

2.13 Me deklaratën noteriale (shlyerje detyrimi) nr. *****, datë 21.10.2015, deklaruesit shoqëria "*****" sh.a. dhe shtetasit Olsi dhe Sh. Xh., deklarojnë se kanë shlyer shumën prej 4,800 euro,

⁶ Shihni analizën e Komisionit në vijim të këtij vendimi.

ndërsa për shumën 4,000 euro, nuk kemi asnjë detyrim ndaj shoqërisë për shkak se kjo shumë është shpenzuar për disa të meta që kishte sendi. Kjo shumë është zbritur nga kontrata e huas.

2.14 Transaksioni për blerjen e kësaj pasurie është konfirmuar edhe nga DPPPP-ja, me shkresën nr. **** prot., datë 12.5.2017. Sipas DPPPP-së në datën 25.4.2014, subjekti ka blerë një apartament me çmim të deklaruar 51,600 euro nga pala shitëse shtetasja T. B., e datëlindjes 8.11.1957, përfaqësuese ligjore e shoqërisë “****” sh.a. me NIPT *****.

2.15 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, si vijon:

- në deklaratën e interesave private periodik/vjetor të vitit 2014, subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti me kontratën nr. ****, datë 2.4.2014. Kontrata e shitjes do të lidhet brenda datës 1.4.2015, sipas kushteve të kontratës, për vlerën e përgjithshme 51,600 euro;

- në deklaratën e interesave private periodik/vjetor të vitit 2014, në rubrikën “shpenzime të deklarueshme, të dhëna konfidenciale” subjekti ka deklaruar se ka paguar 5,688,000 lekë në favor të shoqërisë “****” sh.a., të përfituara nga kontrata e kredisë, si dhe ka paguar 2,000 euro favor të shoqërisë “****” sh.a., për efekt të kontratës së sipërmarrjes, datë 2.4.2014;

- në deklaratën e interesave private periodik/vjetor të vitit 2014, ka deklaruar kontratë kredie nr. ****, datë 7.5.2014, për shumën 5,770,000 lekë;

- në deklaratën e interesave private periodik/vjetor të viti 2015, subjekti deklaroi pagimin e vlerës 4,800 euro për efekt të kontratës së huas duke deklaruar të shlyer të gjithë detyrimin prej 8,800 euro për disa të meta të sendit të pranuar nga të dy palët.

2.16 Lidhur me këtë pasuri dhe deklaratimet e subjektit, Komisioni gjatë hetimit konstatoi disa pasaktësi dhe kërkoi shpjegime nga subjekti në lidhje me:

- vënien në dispozicion të kopje të dokumentacionit provues për të gjitha pagesat e kryera ndaj palës shitëse, për blerjen e kësaj pasurie;

- pse është deklaruar se për blerjen e kësaj pasurie është përdorur kredia e marrë në BKT, në shumën 5.770.000 lekë, datë 12.5.2014, kurse kontrata e blerjes së pasurisë është e datës 25.4.2014 (sipas kontratës së shitblerjes shuma është likuiduar e plotë jashtë zyrës noteriale para datës 25.4.2014);

- të provojë dhe dokumentojë mundësitë financiare të vjehrrit për dhurimin e shumës prej 1,000,000 lekë në vitin 2010, të ardhura të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie;

- të shpjegojë si është disponuar kjo shumë e dhuruar prej 1,000,000 lekësh nga viti 2010 deri në vitin 2014 dhe pse nuk është deklaruar si gjendje apo likuiditet në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011 – 2014;

- të deklarojë çfarë të metash ka pasur sendi në momentin e dorëzimit, si dhe të deklarojë dhe provojë vlerën e shpenzimeve të kryera për riparimin e sendit, duke i ndarë sipas viteve përkatëse.

2.11 Pas pyetjes nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit, subjekti deklaroi⁷ se:

“Çmimi i apartamentit është mbuluar nga këto pagesa: shuma 5,688,000 lekë nga kredia; shuma 2,000 euro nga kursimet vetjake në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe 4,800 euro paguar në datën 21.10.2015 (vërtetuar me deklaratë për shlyerje detyrimi datë 21.10.2015).

Lidhur me ekzistencën e një difference kohore ndërmjet momentit të lidhjes së kontratës së shitjes së apartamentit dhe disbursimit të kredisë është për shkak se mënyra e formulimit të kontratës nga noteri përmban në vetvete kontradikta, por që gjithsesi, nuk cenon vullnetin e

⁷ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të subjektit në dosjen e Komisionit.

palëve në lidhjen e kontratës dhe qëllimin e vërtetë të palëve gjatë lidhjes së saj. Lidhur me pyetjen që ka të bëjë me provimin dhe dokumentimin e mundësive financiare të vjehrrit për dhurimin e shumës prej 1.000.000 lekësh në vitin 2010, e kam objektivisht te pamundur ta siguroj brenda afatit 7-ditor”.

2.18 Për të vërtetuar deklaratimet e tij, lidhur me vlerat dhe pagesat e kryera, subjekti paraqiti:

- a) *kopje e kontratës së shitjes nr. ****, datë 25.4.2014, me të cilën vërtetohet fakti i pagimit të shumës 2,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës;*
- b) *printim dokumenti për transferimin e shumës së përfituar nga kredia në llogari të shoqërisë “****” sh.a. (që vërteton pagimin e shumës 5,688,000 lekë në llogari të shitësit);*
- c) *deklaratë noteriale për shlyerje detyrimi nr. ****, datë 21.10.2015 (që vërteton pagimin e shumës 4,800 euro).*

2.19 Në shpjegimet e paraqitura sipas pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, deklaroi:

“Shuma e dhuruar prej vjehrrit 1,000,000 lekë, është shpenzuar në këtë mënyrë: është paguar në datën 21.10.2015, vlera 4,800 euro për efekt të pagimit të çmimit të apartamentit që nuk mbulohej në momentin e hartimit të kontratës së shitjes.

Shpenzuar shuma 300,000 lekë për disa punime shtesë dhe mobilimin e apartamentit në vitin 2015 dhe ndonjë diferencë e vogël që rezulton duke zbritur dy shpenzimet e kryera më lart, duhet të jetë shpenzuar për nevoja familjar”.

Lidhur me shpenzimet e kryera, për blerjen e pajisjeve të mobilimit apo punimeve të kryera në banesë, në shumën prej 300,000 lekësh, subjekti ka deklaruar se nuk disponon fatura.

2.20 Për të vërtetuar deklaratimet e tij, subjekti ka paraqitur në Komision një deklaratë për shlyerje detyrimi të datës 21.10.2015, ku deklarohet kryerja e pagesës prej 4,800 euro, ndaj shoqërisë “****” sh.a.

2.21 Nga Komisioni me anë të pyetësorit⁸ iu kërkua subjektit të paraqesë dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e vjehrrit. Për këtë subjekti ka paraqitur disa prova shkresore që provojnë të ardhurat e familjes së vjehrrit, si dhe ka deklaruar se pritet të paraqitet dokumentacioni provues lidhur me të ardhurat e dëmshpërblimit të përfituar nga Ministria e Financave.

2.22 Gjithashtu, subjekti në përgjigje të pyetësorit⁹, ka deklaruar edhe se:

“Shumën e përfituar prej 1,000,000 lekësh në vitin 2010 e kam disponuar cash deri në vitin 2015, pasi nuk kam pasur shtim apo pakësimin e saj ndër vite. Në deklaratën periodike të vitit 2015, pasi kam shpjeguar që kjo shume është shpenzuar plotësisht.

*Lidhur me shlyerjen e shumës prej 8,000 euro, kemi lidhur kontratën e huas, datë 25.4.2014, në të cilën përcaktohet shprehimisht që kjo hua dokumenton detyrimin për pjesën e mbetur të çmimit të shitjes së apartamentit. Me mirëkuptimin e palëve, përfaqësuesit e shoqërisë “****” sh.a. ranë dakord që nga shuma e detyrimit prej 8,800 euro, të zbrisnin një pjesë të saj (4,000 euro), për shkak të mos realizimit të kushteve të kontratës, por duke e konsideruar plotësisht të përfunduar marrëdhënien e huas dhe njëkohësisht të shitblerjes së apartamentit”.*

2.23 Komisioni, për konstatimet e gjetjet e tjera, i rikërkoi subjektit të rivlerësimit të deklaronte se: (i) cili është burimi i këtyre kursimeve vetjake dhe të provojë me dokumentacion, nëqoftëse kjo vlerë është tërhequr nga ndonjë llogari bankare; (ii) shlyerja ose jo e detyrimit të mbetur

⁸ Shihni pyetësorin nr. 3, të dërguar subjektit nga Komisioni.

⁹ Shihni përgjigjet e subjektit sipas pyetësorit nr. 3.

prej 800 euro; si dhe (iii) kur është marrë në dorëzim apartamenti i blerë nga shoqëria “****” sh.a.

2.24 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se: *“Shlyerjet e kryera nga ana ime kanë mbuluar të gjithë çmimin e shitjes. Disbursimi i kredisë është në shumën prej 40,800 euro. Apartamenti është marrë në dorëzim qysh në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes, por është bërë funksional afër fundit të vitit 2015, moment që përkon edhe me hyrjen tonë dhe marrjen e tij në dorëzim në mënyrë faktike”.*

2.25 Në përfundim, pas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, lidhur me mundësitë financiare të vjehrrit për dhënien e shumës 1,000,000 lekë, u hartua nga Komisioni edhe analiza financiare¹⁰.

2.26 Nga shpjegimet e subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur nuk vërtetohet mundësia e vjehrrit për të krijuar të ardhura në shumën prej 1,000,000 lekësh, ku një pjesë e tyre kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti ka deklaruar (në përgjigje të pyetësorit nr. 3) se do të paraqesë edhe dokumentacion provues, lidhur me dëmshpërblimin e përfituar nga vjehri i tij, gjë që se ka paraqitur deri në përfundim të rezultateve të hetimit. Gjithashtu, nga Komisioni nuk rezultoi që subjekti të këtë pasur ndonjë çështje gjyqësore me shoqërinë “*****” sh.a., konfirmuar kjo nga gjykatat përkatëse.

2.27 Në përfundim të hetimit, për këtë pasuri, Komisioni konstatoi:

a. Nga përgjigjet dhe provat e sjella nga subjekti nuk arrihet të provohet mundësia financiare për krijimin e burimit të ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare për krijimin e shumës prej 1,000,000 lekësh të deklaruar si dhurim nga vjehri.

b. Lidhur me kredinë e përfituar u konstatua se pavarësisht faktit se kredia është tërhequr disa ditë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes, ka kaluar nga BKT-ja, në datën 12.5.2014 dhe, po në këtë datë, kjo vlerë prej 5,770,000 lekësh i ka kaluar palës shitëse shoqërisë “*****” sh.a.

c. Kontrata e sipërmarrjes, datë 2.4.2014, për prenotim apartamenti ka përcaktuar se kësti i dytë në shumën prej 40,000 euro, do të paguhet prej një kredie bankare që subjekti i rivlerësimit do marrë në BKT.

2.28 Komisioni, në përfundim të rezultateve të hetimit, ka konstatuar këtë problematikë për këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj, për të cilën subjekti i rivlerësimit:

Duhet të provojë dhe të dokumentojë bindshëm mundësitë financiare të vjehrrit të tij, për dhurimin e shumës prej 1,000,000 lekësh në vitin 2010, të ardhura të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

2.29 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu la barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni.

2.30 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi se:

“Lidhur me mundësitë financiare të vjehrrit (familjes së tij), për dhënien në vitin 2010 të shumës 1,000,000 lekë në formën e prikës, i qëndroj të gjitha shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorëve paraardhës.

Në funksion të shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorëve, kam paraqitur dokumentacionin provues: vërtetime të DRSSH, lidhur me pagimin e kontributeve të

¹⁰ Shihni analizën financiare të hartuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit.

sigurimeve shoqërore për vjehrrën F. G. dhe vërtetimin me datë 4.12.2020, lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja për periudhën janar 2008 – maj 2010.

*Nga Ministria e Financave lidhur me masën e dëmshpërblimit të akorduar për të atin e vjehrrit, B. G., si dhe shumat e tërhequra për shkak të tij, nëpërmjet shkresës nr. ***** prot., datë 25.1.2021, është kthyer përgjigje e pjesshme, duke dhënë sqarime vetëm lidhur me shumën e dëmshpërblimit të akorduar, por jo atë të tërhequr efektivisht, me argumentin që bashkëshortja ime nuk është trashëgimtare e të ndjerit B. G., ku bëhet e ditur se shuma e përfitimit të akorduar është në vlerën 3,379,018 lekë”.*

2.31 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti prova për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për pasurinë apartament banimi në Korçë.

2.32 Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar si dhurim nga vjehri në shumën prej 1,000,000 lekësh, në vitin 2010.

2.33 Subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e pretenduar nga vjehri i tij. Lidhur me të ardhurat nga emigracioni këto ngelën vetëm në kuadër deklarativ nga subjekti të pa shoqëruar me ndonjë dokumentacion provues shkresor.

2.34 Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga dëmshpërblimi, subjekti ka deklaruar se kursimet e akumuluar, ndër vite, nga puna e prindërve të bashkëshortes, të hollat e përfituara nga statusi si të përndjekur politikë, të cilave u janë shtuar të ardhurave të krijuara nga puna e bashkëshortes prej janarit të vitit 2008 deri në momentin e martesës në maj të vitit 2010 (këto të fundit sipas shpjegimeve të bashkëshortes dhe familjarëve pothuajse janë kursyer prej saj duke u administruar nga prindërit), kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës 1,000,000 lekë, e cila është dhënë si prikë pas martese, me qëllim ndihmesën për ndërtimin e jetës së ardhshme familjare.

2.35 Subjekti paraqiti dokumentacion lidhur me të ardhurat e pretenduara nga vjehra si e punësuar pranë OSHEE-së. prej vitit 2006 e në vazhdim. Para vitit 2006, subjekti pretendoi se vjehra e tij ka qenë e punësuar si shitëse në subjekte private, por e pasiguruar dhe për këtë nuk ka paraqitur dokumentacion provues.

2.36 Subjekti paraqiti pretendime lidhur me të ardhurat e bashkëshortes si e punësuar pranë FRDSKSH (Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor) Drejtoria Rajonale Korçë, prej vitit 2008. Komisioni mori në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të vërtetuar nga institucionet përkatëse dhe i pasqyroi në analizën financiare për të provuar mundësitë financiare të familjes së bashkëshortes para martese¹¹.

3.37 Në funksion të shpjegimeve të dhëna me sipër, subjekti paraqiti dokumentacionin provues si vijon:

- vërtetime të DRSSh-së, lidhur me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore për vjehrrën F. G.;
- vërtetim datë 4.12.2020, lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja për periudhën janar 2008 – maj 2010.

2.38 Në përfundim, Komisioni, bazuar në dokumentacion shkresor që paraqiti subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, konkludoi analizën financiare lidhur me mundësitë e personit të lidhur, vjehrrit të subjektit, për dhënien e shumës prej 1,000,000 lekësh.

¹¹ Shihni analizën financiare në pikën 2.38 të këtij vendimi.

Analiza për dhënien e shumën 1,000,000 lekë, prikë nga prindërit e bashkëshortes

Të ardhura F. G. 2006 – prill 2010	1,034,029
Të ardhura Sh. G. 2008 – prill 2010	569,665
Të ardhura totale 2006 – prill 2011	1,603,694
Shpenzime jetese 2006 – prill 2010 - 3 persona	1,694,871
Dhënë vajzës Sh. G., maj 2010	1,000,000
Pamundësia e dhënies 1,000,000 lekë	-1,091,177

2.39 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

3. Pasuri të luajtshme të deklaruara nga subjekti

Hetimi i kryer nga Komisioni

3.1 Subjekti ka deklaruar se aktualisht nuk disponon pasuri të luajtshme në pronësi apo përdorim (të detyrueshme për deklaram).

Subjekti ka paraqitur një historik të automjeteve (pavarësisht se aktualisht nuk disponon të tillë), si vijon:

- automjet tip “BMW” me targa *****, blerë me kontratën nr. ****, datë 14.6.2003, në shumën 250,000 lekë;
- shitur automjeti më sipër me kontratë nr. ****, datë 26.5.2006, në shumën 250,000 lekë;
- blerë automjeti me targa *****, në vlerën 400,000 lekë, me kontratë shitje nr. ****, datë 5.4.2006;
- automjeti i mësipërm dalë jashtë qarkullimi në datën 17.11.2015 (jashtë përdorimit).

3.2 Për këto pasuri të luajtshme të deklaruara rezultoi:

- Kontratë shitje nr. ****, datë 14.6.2003, për blerjen nga shtetasi Gj. T. të autoveturës tip “BMW”, me targa *****, në vlerën 250,000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. ****, datë 26.5.2006, për shitjen e autoveturës tip “BMW” blerësit B. T., me targa **** *, me vlerë 250,000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. ****, datë 5.4.2006, për blerjen nga shtetasi J. K. të autveturës tip “BMW”, me targa *****, në vlerën 400,000 lekë.
- Vërtetim nr. **** prot., datë 4.1.2017, nga DPSHTRR-ja, për heqjen nga qarkullimi përfundimisht në datën 17.11.2015 të autoveturës tip “BMW”, me targa *****.

3.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. **** prot., datë 18.7.2017, nuk konfirmon automjete në pronësi aktive të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

3.4 Gjithashtu, DPSHTRR-ja, me shkresën nr. **** prot., datë 6.3.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit disponon një automjet në pronësi, i blerë më 10.7.2017 (pas plotësimit të deklaratës *Vetting*), në vlerën 270,000 lekë.

3.5 Në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar saktë pasuritë e luajtshme, si më sipër, të blera dhe të shitura ndër vite.

3.6 Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, blerjen e automjetit tip “BMW” në datën 14.6.2003, në shumën 250,000

lekë. Burim për blerjen e kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e nënës dhe të vëllait nga emigracioni.

3.7 Nisur nga fakti se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me burimin e kësaj pasurie të luajtshme (e cila nuk disponohej nga subjekti në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*), iu kërkuan shpjegime subjektit të rivlerësimit.

3.8 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹², subjekti ka deklaruar se: “ *Për sa i përket mundësive financiare të nënës dhe të vëllait dhe mundësisë së vërtetimit me dokumentacion shoqëruar të të ardhurave të krijuara prej tyre, për këtë aspekt kam dhënë përgjigje në pyetjen nr. 1 dhe i qëndroj të gjitha argumenteve të parashtruara në këtë përgjigje. Dua të shtoj që deri në vitin 2010 (vit në të cilin kam lidhur martesë), kemi qenë pjesë e një ekonomie familjare duke ndihmuar dhe mbështetur reciprokisht njeri-tjetrin sipas mundësisë dhe nevojave. Kompleksiteti i marrëdhënieve familjare e bën të pamundur detajimin në vlera monetare të çdo aspekti të këtyre marrëdhënieve, por në parim, mund të shprehem që për shkak të të ardhurave relativisht të kënaqshme të krijuara nga nena në emigracion, kam gjetur mbështetje të vazhdueshme prej saj në mbulimin e shpenzimeve të caktuara, ku përfshihet edhe rasti në fjalë”.*

3.9 Vlerat financiare për shitjen dhe blerjen e këtyre pasurive të luajtshme, ndër vite, për të cilat është provuar burimi i ligjshëm, janë përfshirë në analizën financiare.

3.10 Për sa i përket analizës financiare për automjetin e blerë në vitin 2006, si burim për këtë pasuri në pyetësorin nr. 2¹³, është deklaruar kredia e marrë në “Tirana Bank” në vlerën 370,000 lekë, si dhe kursime të përbashkëta familjare. Pas verifikimit rezultoi se subjekti i ka pasur mundësitë financiare për blerjen e këtij automjeti.

3.11 Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të blerjes së pasurisë automjet në vitin 2003, në vlerën 250,000 lekë. Në analizën financiare nuk janë marrë parasysh të ardhurat e përfituara, më pas, nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2006, në vlerën prej 250,000 lekë, për deri sa subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të blerjes së kësaj pasurie.

3.12 Në përfundim janë konstatuar këto problematika për këtë pasuri dhe burimin e krijimit nga Komisioni, për të cilat subjektit iu kalua barra e provës:

Subjekti duhet të provojë mundësitë financiare për blerjen e automjetit në vitin 2003, në vlerën 250,000 lekë, ku si burim ka deklaruar të ardhurat e nënës dhe vëllait nga emigracioni.

3.13 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu la barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni.

3.14 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se:

“Si burim për krijimin e kësaj pasurie, kam deklaruar kontributin e nënës nga të ardhurat e krijuara prej saj nga emigracioni duke paraqitur shpjegime të hollësishme në përgjigje të argumentit për kontributin e saj edhe për krijimin e pasurisë apartament me sip. 85 m². Referuar analizës financiare të vënë në dispozicion nga ana juaj, për vitin 2003 kam rezultuar me një bilanc pozitiv për shumën 22,911 lekë, bilanc i cili ka rezultuar si i tillë edhe duke mos u marrë në konsideratë dhurata e dhënë. Njëkohësisht unë kam filluar punë në vitin 2002, vit në të cilin mund të thuhet që për shkak të mënyrës së njëjtë të jetesës sikurse në vitin 2003, kam rezultuar me bilanc pozitiv. Thënë ndryshe, blerja e kësaj pasurie jo vetëm ka qenë e përbalueshme, por përsëri do të duhej të kisha akumuluar edhe kursime. Nga sa më sipër, në thelb këtë pasuri, unë e justifikoj edhe me të ardhurat e mia (tepricat e të cilave nuk i kam

¹² Përgjigjet e dërguara nga subjekti me e-mail në datën 2.10.2020.

¹³ Shihni përgjigjen e subjektit sipas pyetësorit nr. 2.

deklaruar as si kursime as si burim i ndonjë shpenzimi tjetër), çka logjikisht çon në përfundimin që nuk kam pasur asnjë interes për të deklaruar një burim tjetër për blerjen e automjetit. Arsyeja e vetme e këtij deklarimi ka qenë sikundër edhe në raste të tjera për të cilat kam dhënë shpjegime të hollësishme, pasqyrimi me vërtetësi maksimal i çdo transaksioni dhe burimit të tij, si dhe përmbushja e detyrimit ligjor për deklarimin e çdo dhurate të kryer nga të afërmit apo persona të tjerë. Për këtë arsye, nuk e gjej me vend përfundimin për mospërfshirjen e çmimit të shitjes së automjetit në vitin 2006, si të ardhur në analizën financiare të vitit 2006”.

3.15 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti prova për të kundërshtuar dhe për të rrëzuar gjetjet e Komisionit për pasurinë automjet të blerë në vitin 2003.

3.16 Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar për blerjen e pasurisë automjet në vlerën prej 250,000 lekësh.

3.17 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

4. Kontratë kredie bankare

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.1 Subjekti ka lidhur kontratë kredie bankare nr. *****, datë 7.5.2014 pranë noteres F. B., pjesë e Dhomës së Noterisë Korçë, me palë kreditore BKT dega Korçë, kredimarrës Olsi Xhavella, dorëzanës Sh. Xh., për shumën 5,770,000 lekë. Afati i shlyerjes është caktuar 240 muaj (20 vjet), interesi, norma e bonove të thesarit plus 2.2 % (qëllimi i kredisë, blerja e një apartamenti të përshkruar në faqen nr. 5 të deklaratës).

4.2 Rezultoi se deri më 31.12.2016 është shlyer vlera e kredisë në shumën prej 1,285,328 lekësh (principal + interesa). Mbetja e kredisë është në vlerën 5,353,829 lekë.

4.3 Sipas *statement*-it “nxjerrje e llogarisë së subjektit në BKT”, deri më 20.1.2017, subjekti është me gjendje të pashlyer në shumën 5,339,968,23 lekë.

4.4 Për këtë pasuri është lidhur edhe një kontratë hipotekimi me nr. *****, datë 7.5.2014, nga BKT-ja, për bllokimin e pasurisë nr. *****, me qëllimin e sigurimit të kredisë në shumën 5,770,000 lekë.

4.5 Në përfundim të hetimit Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit për kredinë e përfituar dhe shlyerjen e saj ndër vite.

5. Detyrim paradhënie bankare (*overdraft*) për deklaruesin Olsi Xhavella për shumën 300,000 lekë, financuar në datën 4.7.2016. Vlera e mbetur deri në datën 23.1.2017 rezulton 300,000 lekë.

5.1 Bazuar në vërtetim nr. ***** prot., datë 23.1.2017, të “Credins Bank”, rezultoi se z. Olsi Xhavella është financuar me paradhënie bankare me afat 12-mujor në datën 4.7.2016, në vlerën 300,000 lekë. Vlera e mbetur, datë 23.1.2017, është 300,000 lekë.

5.2 “Credins Bank”, me shkresën nr. *****, datë 5.8.2020 (*statement* bankar) konfirmohet se shtetasi Olsi Xhavella është klient i kësaj banke, me llogari page në vlerën – 298,421 lekë, në datën 31.12.2016.

5.3 Në përfundim të hetimit dhe pas shpjegimeve të sjella nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe në analizën financiare vlera e *overdraft*-it nuk është llogaritur si shpenzim vjetor.

6. Detyrim paradhënie bankare (*overdraft*) për bashkëshorten dhe deklaruesin, për shumën 90,000 lekë, financuar në datën 13.12.2016. Vlera e mbetur deri më 27.1.2017 rezulton 90,000 lekë.

6.1 “Credins Bank” ka lëshuar vërtetim nr. **** prot., datë 27.1.2017, nëpërmjet të cilit vërtetohet se znj. Sh. G. është financuar me paradhënie bankare me afat 12-mujor në datën 13.12.2016, në vlerën 90,000 lekë. Vlera e mbetur në datën 27.1.2017 është 90,000 lekë.

6.2 “Credins Bank”, me shkresën nr. ****, datë 5.8.2020 (*statment* bankar), konfirmon se shtetasi Olsi Xhavella është klient i kësaj banke, me llogari page në vlerën – 81,861 lekë, në datën 31.12.2016.

6.3 Në përfundim të hetimit dhe pas shpjegimeve të sjella nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe në analizën financiare vlera e *overdraft*-it nuk është llogaritur si shpenzim vjetor.

7. Kontratë huaje, datë 9.8.2013, me huadhënës SHKK *****, huamarrës Sh. G. Xh. (bashkëshortja e deklaruesit), për shumën 500,000 lekë, afati i shlyerjes 2 vjet dhe interes 16%. Kësti mujor në vlerën -24,500 lekë. Pas prillit të vitit 2014, kredia u riororganizua me kontratën e datës 29.4.2014 duke u zgjatur afati i shlyerjes në 4 vjet dhe duke u ulur kësti mujor në vlerën 9,900 lekë (deklarimi i pasqyruar edhe në f. 7 të deklaratës). Teprica e huas në momentin e deklaramit është në vlerën 116,600 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.1 Rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. Sh. G., si palë huamarrëse, ka lidhur kontratë huaje me shoqërinë e kursim-kreditit “*****” Dega Korçë, nr. *****, datë 9.8.2013, për shumën 500,000 lekë.

7.2 Shlyerja e kredisë është bërë për periudhën 6.9.2013 – 6.8.2015.

7.3 Rezultoi dhe një kontratë huaje nga shoqëria e kursim-kreditit “*****”, nr. *****, datë 29.4.2014, me huamarrëse Sh. G., për shumën 330,000 lekë. Kjo kredi është shlyer për periudhën 9.6.2014 – 7.2.2018.

7.4 Unioni SHKK-ve “*****” Dega Korçë, me shkresën datë 6.7.2017, konfirmoi se znj. Sh. T. G. është anëtare pranë shoqërisë së kursim-kreditit “*****” ish-Unioni “*****”, tani “*****” Dega Korçë dhe ka shlyerje huaje në proces me vlerën 330,000 lekë, si detyrim financiar pranë këtij institucioni financiar. Teprica e huas, e mbetur në datën 31.7.2017, është 104,900 lekë.

7.5 Subjekti i rivlerësimit është pyetur lidhur me qëllimin e marrjes së kredisë në vitin 2014.

7.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar: “*Kredia e mësipërme, sikurse e kam deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2014, pavarësisht se në dukje jep përshtypjen e një kredie të re, në thelb përfaqëson ‘ristrukturim’ të kredisë së datës 9.8.2013. Kjo e fundit ka qenë e lidhur për një afat 2-vjeçar me këst mujor 24,500 lekë/muaj. Pra, rezulton qartë që kontrata e kredisë e datës 29.4.2014, përfaqëson në thelb ndryshim të kushteve të kontratës së kredisë së datës 9.8.2013, për sa i përket afatit dhe këstit mujor.*

Në këtë kuptim, meqenëse ‘kredia’ e mësipërme është në thelb vazhdim i kredisë paraardhëse, por me kushte të ndryshuara për sa i përket afatit dhe shumës së këstit mujor, qëllimi i saj është i pandashëm nga ai i kontratës së datës 29.4.2014, për të cilën kam dhënë shpjegime në përgjigje të pyetjes nr. 5 të këtij pyetësori”.

7.7 Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit. Duket se kredia e marrë në vitin 2014 në vlerën 330.000 lekë, nga huadhënësja SHKK *****, është vazhdim (ristrukturim) i kredisë së marrë në vitin 2013, në vlerën 500,000 nga i njëjti huadhënës.

8. Detyrime të mëparshme, të shlyera para deklaratës “Vetting”

Hetimi i kryer nga Komisioni

8.1 Subjekti ka deklaruar kontratën nr. *****, datë 27.2.2006, për hua afatmesme, kreditor “Tirana Bank” sh.a., debitor Olsi Xhavella, për shumën 370,000 lekë, me afat 3-vjeçar dhe interes 7% mbi interesin vjetor të bonove të thesarit. Huaja është shlyer në vitin 2009, gjithsej principal+interesa në vlerën 458,022 lekë.

8.2 Rezultoi se subjekti ka lidhur kontratë kredie nr. *****, datë 27.2.2006 dhe plan amortizimi kredie nga “Tirana Bank”, për kredinë e marrë në shumën 370,000 lekë nga z. Olsi Xhavella me dorëzanës G. S..

8.3 Bazuar në ekstrakte nga “Tirana Bank” për llogarinë në emër të z. Olsi Xhavella, printuar në datën 17.10.2016 lidhur me veprimet për kredinë e përfituar në datën 6.3.2006, në shumën 370,000 lekë dhe shlyerjet e saj.

8.4 Sipas përgjigjes së “Tirana Bank”¹⁴ dhe *statement*-it bankar duket se kredia është mbyllur në vitin 2009. Veprimet dhe shlyerjet e bëra për këtë kredi janë pasqyruar në analizën financiare.

8.5 Subjekti ka lidhur kontratë kredie datë 31.8.2011, kreditor “Union Bank” sh.a., debitor shtetasit Olsi dhe Sh. Xh., për shumën 400,000 lekë, me afat 2-vjeçar dhe interes 18%. Shlyer në vitin 2013. Shlyer gjithsej në vlerën 481,299 lekë.

8.6 Kontrata e kredisë datë 31.8.2011, me huamarrës shtetasit Olsi dhe Sh. Xh. dhe huadhënës “Union Bank” dhe anekse kontrate nga kjo bankë, rezultoi në shumën 400,000 lekë. Kjo kredi është shlyer për periudhën 3.10.2011 – 3.8.2013.

8.7 “Union Bank”, me shkresën nr. ***** prot., datë 18.7.2017, konfirmon se shtetasit Olsi dhe Sh. G. kanë qenë klientë të kësaj banke, por në datën 30.1.2017, nuk rezultojnë me produkte bankare aktive.

8.8 Sipas përgjigjes së “Union Bank”¹⁵ dhe *statement*-it bankar duket se kredia është mbyllur në vitin 2013. Shlyer gjithsej principal+interesa në vlerën 481,300 lekë. Veprimet dhe shlyerjet e bëra për këtë kredi janë pasqyruar në analizën financiare.

8.9 Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit

¹⁴ Shihni përgjigjen e “Tirana Bank” në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shihni përgjigjen e “Union Bank” në dosjen e Komisionit.

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: OLSI S. XHAVELLA															
	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	250,000	2,900,000	78,349	332,964	-86,704	-117,094	24,387	946,956	-28,855	76,159	-43,892	7,290,090	-1,023,462	-197,324	10,401,574
Apartament 85 m2 Korçe - 2.900.000 leke - 2004 - Olsi Xhavella - 100%		2,900,000													2,900,000
Apartament 111.51 m2 - 51.600€ - 2014 - Olsi Xhavella & Sh. Xh. - 50%												7,229,676			7,229,676
Automjet BMW ***** - 250.000 leke - 2003 - Olsi Xhavella -100%	250,000														250,000
Automjet BMW ***** - 400.000 leke - 2006 - Olsi Xhavella -100%				400,000											400,000
Ndryshim ne likuiditet	0	0	78,349	-67,036	-86,704	-117,094	24,387	946,956	-28,855	76,159	-43,892	60,414	-1,023,462	-197,324	-378,102
DETYRIME	0	1,901,100	-183,810	106,456	-298,726	-340,321	-249,657	-208,215	150,939	-400,460	24,176	6,499,537	-937,574	-269,052	5,794,393
Kredi tek Alpha Bank - 15.000€ - 2004		1,901,100	-183,810	-185,555	-181,365	-184,774	-205,755	-208,215	-207,450	-209,580	-210,315	-210,165			-85,883
Hua afatmesme Banka e Tiranes - Olsi Xhavella - 370.000 leke - 2006				292,010	-117,361	-130,747	-43,902								0
Kredi NOA - Olsi Xhavella - 200,000 leke - 2008						-24,800									-24,800
Kredi Union Bank - Olsi Xhavella & Sh. Xh. - 400.000 leke - 2011									358,389	-190,880	-167,509				0
Hua nga ***** - Sh. Xh. - 500.000 leke - 2013											402,000	-453,000			-51,000
Hua nga ***** - Sh. Xh. - 330.000 leke - 2014												250,000	-120,000	-100,000	30,000
Kredi BKT - Olsi Xhavella - 5.770.000 leke - 2014												5,679,734	-156,854	-169,052	5,353,829
Detyrim ndaj **** shpk per 8,800 euro - 2014												1,232,968	-660,720		572,248
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	250,000	998,900	262,159	226,508	212,022	223,227	274,044	1,155,171	-179,794	476,620	-68,069	790,553	-85,889	71,728	4,607,180
TE ARDHURA dokumentuar	566,875	767,238	783,128	821,725	816,711	805,680	911,701	989,795	1,161,157	1,282,072	1,544,585	1,644,729	1,553,086	1,607,451	15,255,933
Të ardhura nga paga subjekti	566,875	767,238	783,128	821,725	816,711	805,680	911,701	824,673	894,497	957,169	961,292	1,295,525	1,220,649	1,210,878	12,837,741
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit	0	0	0	0	0	0	0	165,122	266,660	324,903	583,293	349,204	332,437	396,573	2,418,192
															0
SHPENZIME	93,964	119,185	318,921	465,512	354,776	314,452	286,298	395,527	888,982	794,973	1,248,744	1,114,874	1,863,515	1,336,159	9,595,884
Shpenzime jetese	93,964	93,964	109,557	109,557	136,620	136,620	136,620	318,780	409,860	418,644	423,072	788,326	897,104	940,368	5,013,056
Shpenzime interesi kredi 15.000€ - Alpha Bank - 2004 - Olsi Xhavella		25,221	110,107	111,641	99,873	107,505	74,427	46,208	52,273	46,421	31,013	6,386			711,076
Shpenzime interesi kredi 370.000 leke - 2006 - Tirana Bank - Olsi Xhavella				35,256	35,460	16,127	1,179								88,022
Shpenzime interesi+kom.+sig. kredi 5.770.000 leke - 2014 - BKT - Olsi Xhavella												275,327	364,957	333,567	973,851
Shpenzime interesi kredi 400.000 leke - 2011 - Union Bank - Olsi Xhavella +Sh. Xh.									18,551	49,770	12,979				81,300
Shpenzime mjekesore 400,000 leke per te cilin eshte marre kredi - 2011									400,000						400,000
Shpenzim per rregullim shtepie 500,000 leke per te cilin eshte marre kredi - 2013											500,000				500,000
Shpenzim per punime shtese dhe mobilim ne apartament - 300,000 leke - 2015													300,000		300,000
Shpenzime udhetimi			99,257	209,058	82,823	54,200	74,072	30,538	8,298	280,139	281,681	44,835	301,454	62,224	1,528,579
Analiza dokumentuar	222,911	-350,847	202,048	129,705	249,912	268,001	351,359	-560,903	451,969	10,480	363,909	-260,698	-224,540	199,564	-1,396,988
												Pamundesia financiare totale			-1,396,988

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga “Raiffeisen Bank”, “Tirana Bank”, “Union Bank”, “Alpha Bank”, BKT, “Credins Bank”, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen: (i) të ardhurat nga pagat e subjektit në: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (2001 – 2014); Gjykatën e Apelit Korçë (2014 – 2016); dhe në Universitetin Kristal (2009); (ii) të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit te Drejtoria Rajonale e Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor Korçë (vitet 2008 – 2016) dhe lejet e lindjes (vitet 2010 – 2011 dhe 2014 – 2015).

Të ardhurat e mëposhtme nuk merren parasysh në analizën financiare:

Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “BMW”, me targa *****, në vitin 2006, në vlerën 250,000 lekë – subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të blerjes së këtij automjeti në vitin 2003, prandaj as të ardhurat nga shitja e këtij automjeti nuk konsiderohen si të ligjshme për efekt të analizës financiare.

Të ardhurat nga emigracioni i nënës dhe vëllait në vitin 2004, në vlerën 1,500,000 lekë – subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nga emigracioni të nënës dhe vëllait të tij, prandaj nuk konsiderohen si të ligjshme për efekt të analizës financiare.

Dhurata e deklaruar nga subjekti, e marrë nga nëna për shlyerje të dy kësteve të kredisë në vitin 2007, në vlerën 1,200 euro. Subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nga emigracioni të nënës dhe vëllait, prandaj nuk konsiderohen si të ligjshme për efekt të analizës financiare.

Dhurim nga vjehri për dasmë i deklaruar nga subjekti si prikë në vitin 2010 – në vlerën 1,000,000 lekë. Subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të këtij dhurimi nga familja e vjehrit, prandaj nuk konsiderohen si të ligjshme për efekt të analizës financiare.

c. Shpenzimet ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i); shkresa nr. ***** prot., datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së, e administruar në dosjen e subjektit.

ii) Shpenzime për punime shtesë dhe mobilim për apartamentin në Korçë në vitin 2015, deklaruar nga subjekti në përgjigje pyetëso.

iii) Shpenzimet e shumave për të cilat është marrë kredi:

- në vitin 2008, marrë kredi në vlerën 200,000 lekë, te NOA;
- në vitin 2011, marrë kredi në vlerën 400,000 lekë, në “Union Bank”;
- në vitin 2013, marrë kredi në vlerën 500,000 lekë, në SHKK *****.

iv) Shpenzimet për shlyerjen e principalit dhe interesave të kredive të marra në “Alpha Bank”, “Tirana Bank”, NOA, “Union Bank”, *****/*****/*****, si dhe në BKT.

v) Shpenzimet e udhëtimit.

Metodologjia për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit është bërë duke iu referuar vendimit nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për subjektin E. I.

Në rastet kur qëndrimi është deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor te familjarët e subjektit/bashkëshortes, nuk llogariten shpenzime qëndrimi. Nuk janë marrë në konsideratë

shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshortja kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune.

vi) Në rezultatet e hetimit, vlera e kredisë së marrë në vitin 2004 ishte konsideruar nga Komisioni si shpenzim të kryer në atë vit për arsye se kredia është disbursuar disa muaj pas kontratës së blerjes së pasurisë apartament. Pas dhënies së shpjegimeve nga subjekti, Komisioni vendosi të mos e konsiderojë kredinë si shpenzim shtesë të atij viti.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁶.

d. Në përfundim janë konstatuar këto problematika për këtë pasuri dhe burimin e krijimit nga Komisioni për të cilat i kaloi subjektit barrën e provës:

Bazuar në analizën financiare, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditetit dhe shpenzimet e kryera, si dhe blerjet e pasurive.

e. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu la barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për krijimin e të ardhurave të ligjshme.

Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit lidhur me kredinë e përfituar në vlerën prej 15,000 euro, si dhe shpjegimet lidhur mbi *overdraftet*.

Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, vendosi që vlerën e kredisë së disbursuar prej 15,000 euro në vitin 2004, të mos e konsiderojë si shpenzim shtesë të atij viti.

Në përfundim të hetimit dhe pas shpjegimeve të sjella nga subjekti, Komisioni reflektoi në analizën financiare vlerën e *overdraftit*, e cila nuk është llogaritur si shpenzim vjetor.

Subjekti nuk arriti të provojë mundësitë financiare për vitet 2003 – 2017, ku rezultoi në pamundësi financiare në vlerën prej -1,396,988 lekësh¹⁷.

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për blerjet e pasurive, shtimin e likuiditetit dhe shpenzimet e kryera sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e pikës 4 të nenit 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin përfundimtar me nr. ***** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *****, datë 19.11.2020, të KDZH-së, ku rezulton se:

- formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016;

¹⁶ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷ Shihni tabelën e analizës financiare më sipër në këtë vendim.

- subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës;
- për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar;
- konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Komisioni, pas hetimit, konstatoi se për pastërtinë e figurës së subjektit Olsi Xhavella nuk ka pasur të dhëna dhe dyshime.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera;
- 2) pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënave nga burimet arkivore të KLGj-së.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga gjyqtari Olsi Xhavella

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga gjyqtari Olsi Xhavella, konstatohet si më poshtë:

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, në mënyrë të plotë, të nënshkruar rregullisht dhe pa mangësi nga pikëpamja formale.

Sipas të dhënave të deklaruara nga gjyqtari Olsi Xhavella në rubrikën B të formularit, për periudhën tetor 2002 – mars 2014, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Në periudhën mars 2014 dhe në vijim, gjyqtari deklaroi ushtrimin e detyrës në Gjykatën e Apelit Korçë.

Gjyqtari Olsi Xhavella ka deklaruar se 3 vitet e fundit ka punuar në fushën e së drejtës administrative, civile, penale dhe familjare, ndërsa specializime nuk ka.

Lidhur me ngarkesën sasiore, gjyqtari Olsi Xhavella ka deklaruar këto të dhëna statistikore:

- Për vitet 2014 – 2016 i janë caktuar gjithsej 703 çështje, nga të cilat 60 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë në periudhën janar - mars 2014, si dhe 643 çështje në Gjykatën e Apelit Korçë në periudhën mars 2014 - dhjetor 2016.

- Për vitet 2014 – 2016 ka përfunduar gjithsej 660 çështje, nga të cilat 72 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në periudhën janar - mars 2014, si dhe 588 çështje në Gjykatën e Apelit Korçë, në periudhën mars 2014 - dhjetor 2016.

Gjyqtari ka deklaruar se vitin e fundit të ushtrimit të detyrës ka mbartur gjithsej 21 çështje.

Z. Olsi Xhavella ka deklaruar pjesëmarrje në 4 aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës.

Gjyqtari Olsi Xhavella ka paraqitur tri dokumente ligjore, të cilat janë dhënë brenda periudhës së rivlerësimit “8.10.2013 – 8.10.2016” dhe i përkasin respektivisht secilit vit kalendarik. Nga këto tri dokumente ligjore, 1 është çështje penale themeli dhe 2 janë çështje civile (nga të cilat një është edhe me kundërpadi).

1. Vendimi nr. ****, datë 16.12.2014, i Gjykatës së Apelit Korçë, me të pandehur: V. E., A. U., S. Ç., S. V., të akuzuar për veprën penale “mashtrim”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.
2. Vendimi nr. ****, datë 10.11.2015, i Gjykatës së Apelit Korçë, me palë ndërgjyqëse: paditës të kundërpaditur V. T., N. Sh., i paditur kundërpaditës P. X., S. Th. (X), i paditur në padi dhe kundërpadi ZRPP-ja Korçë, i paditur në kundërpadi AKKP-ja Tiranë, objekti i padisë “lirim dhe dorëzim sendi, detyrim i ZRPP-së të pasqyrojë ndryshimet” dhe objekti i kundërpadisë “anulim vendimi të AKKP-së Tiranë dhe detyrim për njohje pronar”.
3. Vendimi nr. ****, datë 6.7.2016, i Gjykatës së Apelit Korçë, me palë ndërgjyqëse: paditës M. V., kundër të paditurit L. K., person i tretë përmbarues gjyqësor privat, me objekt të padisë “pushim cenimi”.

Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

Dosja 1 – çështja penale nr. **** regj. them., datë 9.10.2014 regjistrimi, akuza e përfaqësuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, kundër të pandehurit B. M., të akuzuar për veprat penale “dhuna në familje” dhe “veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, të parashikuar nga nenet 130/a/4 dhe 321/2 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ****, datë 18.2.2015.

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 9.10.2014 mbi bazë ankimi të të pandehurit dhe me shortin elektronik të datës 16.10.2014 i është caktuar gjyqtarit Olsi Xhavella.

Në dosje mungon akti që tregon caktimin e seancës së parë gjyqësore. Njoftimet për seancën kanë respektuar afatin 10-ditor dhe elementet e njoftimit të përcaktuar nga neni 426 i Kodit të Procedurës Penale.

Seanca gjyqësore, e datës 18.2.2015, është çelur 44 minuta me vonesë dhe është dokumentuar me procesverbal dhe është regjistruar në audio. Në përmbajtje të procesverbalit të mbajtur në mënyrë të përmbledhur nuk dokumentohet shkaku i fillimit me vonesë të gjykimit.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar nga gjyqtari Olsi Xhavella pas dy ditësh, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Vonesa e dorëzimit i atribuohet veprimeve administrative të sekretares gjyqësore.

Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Korçë ka zgjatur 4 muaj e 9 ditë dhe kohëzgjatja e gjykimit nga gjyqtari Olsi Xhavella ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Vendimi përfundimtar nr. ****, datë 18.2.2015, përmban pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivin e gjykatës, në përputhje me kërkesat e nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Ai është konkluzion i analizës së pjesës përshkruese - arsyetuese. Në vendim janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, por nuk përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

Dosja 2 – çështja penale nr. **** regj. them., datë 3.2.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë kundër të pandehurit I. B., akuzuar për kryerjen e veprës penale “organizimi i lotarive të palejuara”, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. ****, datë 23.6.2015.

Në dosje mungon akti që tregon caktimin e seancës së parë gjyqësore. Njoftimet për seancën kanë respektuar afatin 10-ditor dhe elementët e njoftimit të përcaktuar nga neni 426 i Kodit të Procedurës Penale.

Seanca gjyqësore është çelur në orën e planifikuar 09:40 dhe është dokumentuar me procesverbal të mbajtur edhe në mënyrë të përmbledhur dhe është regjistruar në audio.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar nga gjyqtari Olsi Xhavella pas 6 ditësh, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale me vetëm 1 ditë.

Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Korçë ka zgjatur 4 muaj e 18 ditë, jashtë afatit 2-mujor të parashikuar në germen “g”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga gjyqtari Olsi Xhavella nuk ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Është caktuar dhe zhvilluar 1 seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive pasi është disponuar me vendim përfundimtar.

Vendimi përfundimtar nr. ****, datë 23.6.2015, përmban pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivin e gjykatës, në përputhje me kërkesat e nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Ai është konkluzion i analizës së pjesës përshkruese - arsyetuese.

Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

Dosja 3 – çështja penale nr. **** regj. them., datë 19.6.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë kundër shtetasit D. Sh. me objekt “revokim mase sigurimi”, e përfunduar me vendimin nr. ****, datë 30.6.2014.

Në dosje mungon akti që tregon caktimin e seancës së parë gjyqësore. Njoftimet e palëve kanë respektuar afatin 3-ditor dhe elementët e njoftimit të përcaktuar nga neni 249/4 i Kodit të Procedurës Penale.

Seanca gjyqësore e datës 30.6.2014 është çelur me 48 minuta vonesë dhe është dokumentuar me procesverbal të mbajtur në mënyrë të përmbledhur, të dokumentuar edhe në sistem audio.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar nga gjyqtari Olsi Xhavella brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes nga gjyqtari Olsi Xhavella ka zgjatur 7 ditë, brenda afatit 10-ditor të parashikuar në nenin 249/5 të Kodit të Procedurës Penale.

Është caktuar dhe zhvilluar 1 seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive. Njoftimet kanë respektuar afatin 3-ditor dhe elementët e njoftimit të përcaktuar nga neni 249/4 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi përfundimtar nr. *****, datë 30.6.2014, përmban pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivin e gjykatës, në përputhje me kërkesat e nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Ai është konkluzion i analizës së pjesës përshkruese – arsyetuese.

Kundër vendimit rezulton të jetë ushtruar rekurs. Me vendimin nr. *****, datë 6.11.2014, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranim rekursi.

Dosja 4 – çështja civile nr. ***** regj. them., datë 12.1.2016 regjistrimi, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës M. M. kundër të paditurit DRSSh Korçë me objekt të padisë “njohje vërtetësie dokumenti”, e përfunduar me vendimin nr. *****, datë 28.4.2016.

Në dosje mungon akti që tregon caktimin e seancës së parë gjyqësore, si dhe mungojnë njoftimet me shpallje për seancën e parë gjyqësore.

Seanca gjyqësore e datës 28.4.2016 është çelur 26 minuta me vonesë dhe është dokumentuar me procesverbal të mbajtur edhe në mënyrë të përmbledhur. Gjykimi është zhvilluar në sallë dhe është regjistruar në audio.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar nga gjyqtari Olsi Xhavella pas 11 ditësh, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, por brenda afatit 30-ditor për ushtrim rekursi.

Gjykimi i çështjes nga gjyqtari Olsi Xhavella ka zgjatur 3 muaj e 14 ditë, brenda afatit standard 6-mujor të parashikuar në germën “h”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga gjyqtari Olsi Xhavella ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Është caktuar dhe zhvilluar 1 seancë gjyqësore e cila ka qenë produktive.

Seanca gjyqësore ka qenë publike, është zhvilluar në sallë gjykimi dhe procesverbali është mbajtur edhe në sistem audio, në funksion të solemnitetit dhe transparencës së zhvillimit të gjykimit.

Dosja është e organizuar në drejtim të llojit, mënyrës dhe listimit të akteve. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar ka disa të meta. Akte për caktimin e seancës gjyqësore dhe për njoftimin e palëve/kopje të listës së gjykimeve nuk ka në dosje. Këto të fundit u paraqitën nga arkiva e gjykatës. Nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes sipas nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile. Ankimi dhe parashtrimet e palëve ndodhen në dosje. Në dosje ndodhen 2 kopje vendimesh, të cilat janë të nënshkruara në fund të tij nga të gjithë anëtarët e trupës gjyqësore.

Vendimi përfundimtar nr. *****, datë 28.4.2016, është strukturuar sipas elementëve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile. Ai është i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës.

Mungon e drejta e ankimit në vendim, i cili është i nënshkruar në faqen e fundit nga të gjithë anëtarët e trupës gjyqësore.

Në vendim janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, ndërsa nuk përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Fletët numërtohen, ndërsa teksti i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm, gjithsej 4 fletë. Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar rekurs.

Dosja 5 – çështja civile nr. **** regj. them, datë 20.5.2015 regjistrimi, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditës V. M. kundër të paditurit A. M. etj., me objekt të padisë “pjesëtim sendi”, e përfunduar me vendimin nr. ****, datë 10.11.2015.

Në dosje mungon akti që tregon caktimin e seancës së parë gjyqësore, si dhe mungojnë njoftimet me shpallje për seancën e parë gjyqësore.

Seanca gjyqësore e datës 28.10.2015 është çelur me 10 minuta vonesë dhe është dokumentuar me procesverbal, si dhe është regjistruar në audio.

Seanca gjyqësore datë 10.11.2015 është çelur me 44 minuta vonesë dhe është dokumentuar me procesverbal, si dhe është regjistruar në audio.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar nga subjekti pas 14 ditësh, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308 i të Kodit të Procedurës Civile, por brenda afatit 30-ditor për ushtrim rekursi, ndërsa nga sekretarja gjyqësore në kryesekretari në datën 27.11.2015.

Gjykimi i çështjes nga gjyqtari Olsi Xhavella ka zgjatur 5 muaj e 19 ditë, brenda afatit standard 6-mujor të parashikuar nga germa “h” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë caktuar dhe zhvilluar 2 seanca gjyqësore, të cilat kanë qenë produktive. Të dyja seancat kanë filluar me vonesë, referuar shënimit përkatës në kapakun e dosjes për seancën e parë, pasi mungojnë njoftimet e palëve. Në asnjë rast nuk dokumentohet shkaku i vonesës.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar ka disa të meta. Akte për caktimin e seancës gjyqësore dhe për njoftimin e palëve/kopje të listës së gjykimeve nuk ka në dosje. Këto të fundit u paraqitën nga arkiva e gjykatës. Nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes sipas nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa konstatohet se relatimi orientohet në drejtim të leximit të vendimit të shkallës së parë dhe ankimit përkatës. Në dosje ndodhen shpjegimet e palës së paditur, depozitimi i të cilave nuk gjen pasqyrim në procesverbalin e transkriptuar, 2 kopje vendimi, njëri 6 dhe tjetri 7 fletë, diferencë kjo për shkak të llojit të shkrimit, të nënshkruar nga anëtarët e trupës gjyqësore.

Vendimi përfundimtar nr. ****, datë 10.11.2015, është strukturuar sipas elementëve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, përshkuese - arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës.

Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Ai është konkluzion i analizës së pjesës përshkuese – arsyetuese, bazuar në nenin 466/a të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa nuk është i plotë lidhur me të drejtën e ankimit.

Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar rekurs.

Nuk rezultuan problematika lidhur me 5 çështjet e shqyrtuara për subjektin e rivlerësimit, z. Olsi Xhavella.

Aftësitë profesionale

Gjyqtari Olsi Xhavella ka njohuri të përgjithshme në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe e zgjidh çështjen në bazë të saj.

Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej gjyqtarit Olsi Xhavella janë të thjeshta dhe përgjithësisht të kuptueshme, ku gjuha profesionale është në nivelin e duhur.

Përgjithësisht gjyqtari respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor, por nuk përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Struktura e vendimeve është e standardizuar. Konstatohet se gjyqtari Olsi Xhavella nuk i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat mungon arsytimi dhe nuk tregohet shkaku ligjor.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar i jep përgjigje pretendimeve të palëve.

Gjyqtari Olsi Xhavella, për vitet 2014 – 2016, ka përfunduar gjithsej 660 çështje, nga të cilat 72 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe 588 çështje në Gjykatën e Apelit Korçë në periudhën mars 2014 - dhjetor 2016. Deklarimi nuk detajohet sipas viteve. Gjyqtari ka deklaruar se vitin e fundit të ushtrimit të detyrës ka mbartur gjithsej 21 çështje.

Të dhënat e deklaruara përputhen me ato të vërtetimeve të lëshuara nga gjykatat. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 93.9%.

Sipas të dhënave statistikore për periudhën e rivlerësimit, gjyqtari Olsi Xhavella ka përfunduar 500 çështje, nga të cilat 271 çështje penale dhe 216 çështje civile të përgjithshme dhe 13 çështje familjare.

Konstatohet se gjyqtari Olsi Xhavella ka pasur ngarkesë sasiore nën standardin sasiore, si dhe ka gjykuar brenda afatit standard të gjykimit në katër dosjet e vëzhguara dhe dy dokumentet e paraqitur, ndërsa për dokumentin tjetër kjo e dhënë nuk mund të nxirret. Në 1 dosje të vëzhguar gjykimi është tej afatit. Gjithashtu, rezultoi se gjyqtari ka arsyetuar me vonesë 3 vendime gjyqësore, vonesa të cilat janë minimale me 1-4 ditë dhe, në asnjë rast, nuk tejkalojnë afatin për ushtrimin e rekursit.

Gjyqtari Olsi Xhavella ka aftësi për të kryer shpejt procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në katër nga pesë dosjet e vëzhguara gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shihni dosjet 1, 2, 3 dhe 4), ku në tri rastet e para gjykimet kanë qenë penale, ndërsa rasti i katërt ka qenë gjykim civil. Një tipar pozitiv i punës së tij është zhvillimi i gjykimeve gjithmonë në sallë gjykimi. Nga ana tjetër, nga vëzhgimi i 6 dosjeve është konstatuar se 5 seanca kanë filluar me vonesë të konsiderueshme nga orari i planifikuar (shihni dosjet 1, 3, 4 dhe 5). Vonesat kanë qenë 26 minuta (shihni dosjen 4), 44 minuta (shihni dosjet 1 dhe 5) dhe 48 minuta (shihni dosjen 3), duke mos respektuar nenin 4, të vendimit nr. 238/1/b, datë 24.12.2008, të KLD-së “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”, sipas të cilit “*proceset gjyqësore duhet të fillojnë në respektim të orarit të gjykimit të komunikuar dhe të afishuar në gjykatë, me përjashtim të rasteve kur ka një arsye të justifikuar*”. Vetëm në një rast shkaku i vonesës dokumentohet se ka ndodhur për shkak pjesëmarrjeje të një prej anëtarëve të trupës gjyqësore në një gjykim penal (shihni dosjen 4). Megjithatë, në asnjë rast vonesa nuk ka shkaktuar pasoja të dukshme në zhvillimin e seancave gjyqësore.

Ndër pesë dosje të vëzhguara nuk ka pasur asnjë rast kur gjykata ka vendosur riçeljen e hetimit gjyqësor.

Duhet evidentuar një vendim gjyqësor, nga pesë dosjet e vëzhguara është ankimuar por nuk është cenuar nga Gjykata e Lartë, pra nuk janë evidentuar gabime gjyqësore të kryera prej tij nga kontrolli gjyqësor i brendshëm.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se përgjithësisht aktet themelore të gjykimit janë të rregullta, por në dosjet gjyqësore disa prej akteve mungojnë. Kështu, në të gjitha çështjet nuk ka akte që dokumentojnë caktimin e seancës së parë gjyqësore. Në dy dosje të vëzhguara mungojnë aktet e njoftimit të palëve (shihni dosjet 4 dhe 5). Procesverbali gjyqësor përshkruan veprimet e kryera në seancë, por shkaku e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore nuk e dokumenton (shihni dosjet 1, 3 dhe 5). Në çështjet

penale, procesverbali gjyqësor është nënshkruar në çdo fletë nga sekretari gjyqësor në të gjitha seancat (shihni dosjet 1, 2 dhe 3). Relatimi i çështjes nga gjyqtari bëhet verbalisht në seancë nëpërmjet leximit të vendimit të shkallës së parë dhe ankimit dhe jo me shkrim. Në një rast identifikimi i të pandehurit është bërë nga mbrojtësi i tij pa dokument identifikimi (shihni dosjen 2).

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Olsi Xhavella përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Nga të dhënat e deklaruara nga gjyqtari Olsi Xhavella dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të gjyqtarit Olsi Xhavella, si dhe nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara dhe në procesverbalin gjyqësor në format shkresor është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore, në akte të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është normale, si dhe komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Olsi Xhavella për të bashkëpunuar me kolegët, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në asnjë rast seancat e planifikuara nuk kanë dështuar.

DENONCIMET

Për subjektin e rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, janë paraqitur 23 denoncime, por disa prej tyre janë dërguar nga të njëjtit denoncues disa herë, si vijojnë:

1. Denoncim nr. ** prot., datë 22.11.2017**, i shtetasit K. Ç., i cili ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku dhe në fund ka dhënë pak të dhënë lidhur me praktikën që denoncon.

2. Denoncim nr. ** prot., datë 21.1.2019**, i shtetases I. Z., e cila ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, ku denoncon subjektin e rivlerësimit si pjesë e trupës së Gjykatës së Apelit Korçë, e cila vendosi pushimin e një çështjeje gjyqësore dhe dhënien e një vendimi haptazi në shkelje të ligjit, të pabazuar në ligj dhe në prova.

3. Denoncim nr. ** prot., datë 18.1.2018**, i shtetasit A. L., i cili ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, ku denoncon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ****, datë 31.10.2017, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues i trupës (relator), ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ****, datë 7.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pranimin e padisë.

4. Denoncim nr. ** prot., datë 18.12.2017**, i shtetasit N. M., i cili nuk ka plotësuar formularin e denoncimit nga publiku, por një ankesë. Denoncuesi denoncon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë.

5. Denoncim nr. ** prot., datë 19.12.2017**, i shtetases N. L., e cila ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, ku denoncon subjektin e rivlerësimit për korrupsion dhe vendim të padrejtë.

6. Denoncim nr. ** prot., datë 2.2.2018**, i shtetas Xh. Q., e cila nuk ka plotësuar formularin e denoncimit nga publiku, por një ankesë. Denoncuesi denoncon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë.

7. Denoncim nr. ** prot., datë 18.3.2019**, i shtetasit P. D., i cili nuk ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, por një ankesë ku kërkon që proceset gjyqësore që ka ky denoncues të mos jenë të njëanshme dhe të garantojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

8. Denoncim nr. ** prot., datë 21.3.2019**, i shtetasit M. G., i cili ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, por nuk ka dërguar të dhëna lidhur me praktikën që denoncon.

9. Denoncim nr. ** prot., datë 3.6.2019**, nr. **** prot., datë 24.7.2020 dhe nr. **** prot., datë 16.9.2020, i shtetasit B. M.. Subjekti i rivlerësimit, si pjesë e trupës gjyqësore me vendimin nr. **** , datë 25.3.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. **** , datë 23.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

10. Denoncim nr. ** prot., datë 5.8.2019**, nr. **** prot., datë 29.10.2019 dhe nr. **** prot., datë 22.11.2018, i shtetas N. K.. Denoncuesja ka paraqitur 3 denoncime në Komision që kanë lidhje me të njëjtën çështje.

11. Denoncim nr. ** prot., datë 16.11.2018**, i shtetasit Th. K.. Ky denoncim është për të njëjtën çështje që lidhet me denoncuesen më sipër N. K..

12. Denoncim nr. ** prot., datë 14.8.2019**, i shtetasit R. D., i cili nuk ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, por një ankesë ku pretendon, ndër të tjera, për dhënie vendimi gjyqësor të padrejtë nga trupa gjyqësore, ku subjekti ka qenë anëtar.

13. Denoncim nr. ** prot., datë 18.9.2019**, i shtetas V. T., e cila ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku.

14. Denoncim nr. ** prot., datë 30.9.2018**, i shtetasit K. M., i cili nuk ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, por një ankesë ku pretendon për vendim të padrejtë në të tri shkallët e gjyqësorit.

15. Denoncim nr. ** prot., datë 28.10.2019**, i shtetasit S. G., i cili nuk ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, por një deklaratë dhe rekurs drejtuar Gjykatës së Lartë.

16. Denoncim nr. ** prot., datë 1.11.2018**, i shtetasit A. T., i cili ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, ku pretendon, ndër të tjera, për dhënie vendimi gjyqësor të padrejtë nga trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Korçë, ku subjekti ka qenë anëtar.

17. Denoncim nr. ** prot., datë 1.11.2018**, i shtetasit A. T., i cili ka paraqitur formularin e denoncimit nga publiku, ku pretendon ndër të tjera, për dhënie vendimi gjyqësor të padrejtë nga trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Korçë, ku subjekti ka qenë anëtar.

18. Nisur nga fakte të njohura botërisht, Komisioni është njohur me rastin e subjektit të rivlerësimit M. M., e cila akuzohet për mitmarrje lidhur me çështjen gjyqësore ndaj të pandehurit O. B.. Në përbërje të trupit gjyqësor, lidhur me çështjen në fjalë, rezultoi dhe subjekti i rivlerësimit i cili ka qenë si kryesues dhe relator i çështjes.

Me vendimin nr. ****, datë 29.7.2020, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur ndryshim të masës së sigurisë të dhënë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nga “arrest në burg” në “garanci pasurore”, për 2 të arrestuarit O. B. dhe A. M.

Duket se Gjykata e Apelit Korçë, ku subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, ka qenë relator, ka lehtësuar pozitën e të arrestuarve për dhënien e masës së sigurisë.

Lidhur me këto denoncime dhe gjetjen e Komisionit për faktin e njohur botërisht, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti¹⁸, për këtë çështje deklaroi:

“Nuk e gjej me vend përfundimin sipas të cilit: ‘Duket se Gjykata e Apelit Korçë ku subjekti i rivlerësimi, z. Olsi Xhavella, ka qenë relator, ka lehtësuar pozitën e të arrestuarve për dhënien e masës së sigurisë’.

Caktimi i llojit të masës së sigurimit, ka të bëjë me verifikimin e kushteve ligjore, së pari lidhur me ekzistencën e kushteve të masës së sigurimit (neni 228 i Kodit të Procedurës Penale) dhe më tej, verifikimin e kriterëve për caktimin e llojit të masës së sigurimit (nenet 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale). Këto elemente janë analizuar gjerësisht në vendimin e gjykatës.

Sensiviteti që paraqet çështja në fjalë, për sa i përket nisjes së hetimit ndaj njërit prej anëtarëve të trupit gjykues për akuzën e ‘korrupsionit pasiv’, nuk ka asnjë lidhje me ushtrimin e detyrës nga ana ime, jo vetëm lidhur me rastin konkret, por edhe çfarëdolloj gjykimi tjetër të zhvilluar përgjatë periudhës që mbaj funksionin e gjyqtarit. Vendimmarrja jo vetëm në çështjen në fjalë për në çdo gjykim të zhvilluar dhe përfunduar nga ana ime, i është nënshtruar vetëm bindjes së brendshme, të formuar nga shqyrtimi i provave dhe interpretimi dhe zbatimi korrekt i ligjit (natyrisht brenda kapaciteteve profesionale që zotëroj), por në asnjë rast, nuk ka qenë rezultat i ndonjë ndikimi tjetër të jashtëm apo qëndrimi subjektiv i karakterit paragjykues, apo të paanshëm”.

Pas shpjegimeve të subjektit lidhur me çështjen më sipër, si dhe pas vlerësimit të të gjitha denoncimeve, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer shkelje apo veprime që komprometojnë figurën e tij si gjyqtar.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë nuk krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsye se:

1. Për pasurinë apartament me sip. 85 m²:

- në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për pasurinë apartament banimi me sip. 85 m², në Korçë;
- subjekti nuk arriti të provojë se kredia e përfitur në vlerën 15,000 euro është përdorur si burim për blerjen e kësaj pasurie, si dhe nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar si e ardhur nga nëna e tij në vlerat 700,000 lekë dhe 1,200 euro;
- për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për këto pasuri dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

2. Për pasurinë apartament me sip. 111.51 m²:

¹⁸ Shihni shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

- në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti prova për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për pasurinë apartament banimi në Korçë;
- subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pretenduar në shumën prej 2,000 euro si pagesë e këstit të parë dhe dhurimin nga vjehri në shumën prej 1,000,000 lekësh në vitin 2010;
- për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për këto pasuri dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

3. Analiza financiare për vitet 2003 dhe 2016 – bazuar në të cilën rezultuan balanca negative vjetore për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive:

- për vitin 2004 rezultoi me balancë negative në vlerën 350,847 lekë;
- për vitin 2010 rezultoi me balancë negative në vlerën 560,903 lekë;
- për vitin 2014 rezultoi me balancë negative në vlerën 260,698 lekë;
- për vitin 2015 rezultoi me balancë negative në vlerën 224,540 lekë.

Pra, subjekti ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 1,396,988 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur dhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

4. Duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 1, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon se: “Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në pronësi.

Pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi.

Subjekti gjendet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në parimin e objektivitetit, subjekti nuk ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe të interesave private, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe *cash*) dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar detyrën si gjyqtar.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për pesë çështjet e shortuara, trupi gjykues pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton nga vlerësimi në tërësi i kriterit të pasurisë dhe vlerësimit profesional lidhur me çështjet e gjykuara dhe problematikat e konstatuara nga Komisioni mbi bazën e të dhënave të mbledhura, denoncimet, dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave sipas paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Olsi Xhavella, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.3.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Ertugena Sokoli
Sekretare gjyqësore